

VENDIM
Nr.1068, datë 29.12.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË IEVP BURGU NR.325, BURGU VAQAR, BURGU NR.302, SPITALI I BURGUT TIRANË, IEVP SHËNKOLL, LEZHË, IEVP BËNÇË, TEPELENË, IEVP RROGOZHINË, IEVP LUSHNJË (FSHATI KOSOVË, KOMUNA FIERZË, ELBASAN) DHE TË GODINËS SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të IEVP burgu nr.325, Burgu Vaqar, Burgu nr.302, Spitali i Burgut Tiranë, IEVP Shënkoll, Lezhë, IEVP Bënçë, Tepelenë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Lushnjë (fshati Kosovë, komuna Fierzë, Elbasan) dhe të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Lista me 22 (njëzet e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 9 (nëntë) prona.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha